

Vendim nr. 28 datë 13.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 13.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (Sh) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SHPËTIM KASAPI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1501 (267), datë 29.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shpëtim Kasapi (*kërkuesi*) i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me kërkesëpadi me objekt: “*Kthim shume prej 13.000 euro*”, duke pretenduar se shtetasi A.S., ish-bashkëshorti i vajzës së tij, gjatë martesës me të bijën i ka kërkuar këtë shumë si hua për blerjen e një automjeti të ri në shtetin italian ku ai dhe e bija jetonin. Për shkak të marrëdhënieve të

posaçme familjare, mes tyre nuk është lidhur kontratë huaje dhe, në kushtet kur kanë kaluar më shumë se dy vjet nga dhënia e huasë, kërkuesi ka kërkuar kthimin e saj përmes gjykatës.

2. Me vendimin nr. 201 (64-2016-440), datë 17.03.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, detyrimin e shtetasit A.S. për përmbushjen e detyrimit kontraktor, konkretisht t'i kthejë kërkuesit shumën prej 13.000 eurosh, si detyrim të papaguar. Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar dhe ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm i tij përmes shërbimit përmbarimor.

3. Në vijim, shtetasi A.S. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr. 201 (64-2016-440), datë 17.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

4. Me vendimin nr. 02 (64-2017-33), datë 19.01.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 16, datë 25.01.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Për rekursin e paraqitur nga shtetasi A.S., me vendimin nr. 00-2022-1501 (267), datë 29.06.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimeve nr. 02 (64-2017-33), datë 19.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë e nr. 16, datë 25.01.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe pranimin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. 201 (64-2016-440), datë 17.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

6. Në datën 26.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 00-2022-1501 (267), datë 29.06.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi** ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të *parimit të sigurisë juridike*, për shkak të pranimit nga Gjykata e Lartë të kërkesës së shtetasit A.S. për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, 7 vjet pas paraqitjes së kërkesëpadisë. Sipas kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka marrë të gjitha hapat për njoftimin e këtij shtetasi në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Nga ana tjetër, me qëllim të shmangies së mosmarrjes pjesë në gjykim të shtetasit A.S., ai është investuar edhe vetë për njoftimin e këtij shtetasi në përputhje me parashikimet ligjore, duke marrë vërtetim nga institucioni përkatës për adresën e banimit të tij, si dhe duke vënë në dispozicion të gjykatës numrat e tij të telefonit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

9. Kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 4, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, kërkuari ka kundërshtuar në Gjykatë vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është vendosur ndryshimi i vendimeve nr. 02 (64-2017-33), datë 19.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe nr. 16, datë 25.01.2018 të

Gjykatës së Apelit Vlorë, duke pranuar kërkesën e A.S. për rivendosje në afat të ankimit të tij ndaj vendimit nr. 201 (440), datë 17.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

12. Kolegji thekson se vendimet e gjykatave për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit nuk vendosin për thelbin e çështjes. Procesi gjyqësor që mund të vijojë në zbatim të vendimit nr. 00-2022-1501 (267), datë 29.06.2022 të Gjykatës së Lartë, mundet ose jo të ndryshojë themelin e çështjes, për rrjedhojë vendimi objekt ankimi kushtetues nuk mund të konsiderohet përfundimtar në kuptim të shterimit të mjeteve juridike efektive, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

13. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.